

Informata për zhdëmtimin dhe shpagimin (kompenzimin e viktimës) sipas kodit të viktimës

Parakushtet e përgjithshme

Viktima dhe të afërmit e saj nën parakushte të caktuara kanë të dretën e kompenzimit për dëmet e pësura trupore apo psiqike, në rastin e delikteve seksuale si dhe në rast vdekje. Gjithashtu nën parakushte të caktuara ekziston e drejta e shpagimit në qoftë se shkalla dëmtimit e justifikon këtë. Seicili Kanton për këtë e ka një autoritet përgjegjës. Kërkesa me shkrim për kompenzimin e viktimës nuk kushtëzohet me denoncimin. Shërbimet e autoritetit përgjegjës janë plotësuese ndaj shërbimeve të palëve të treta. Kjo don të thotë që në rend të parë kryesi i veprës apo sigurimi i tij duhet të përgjigjet për dëmin e shkaktuar.

Zyra për Mbrojtjen e Viktimave ju mbështet për skjarimin dhe, nëse është e nevojshme, për realizimin e të drejtave tuaja. Me dëshirë ju këshillojmë për këtë në një bisedë personale.

Në vijim do t'i gjeni informatat më të rëndësishme:

Zhdëmtimi

Zhdëmtimi sipas kodit të viktimës e mbulon dëmin material, i cili është shkaktuar nga një vepër e dhunshme. Këto janë: Dëmi i shkaktuar për shkak të fitimeve të humbura, dëmet si mbajtës i familjes, shpenzimet e varrimit dhe dëmet në buxhetin familjarë. Dëmet ndaj gjërave dhe pasurisë nuk përfshihen.

Nën parakushtet e caktuara mund të shtrohet kërkesa për paradhënie të zhdëmtimit. Ed drejta për zhdëmtim sipas kodit të viktimës mvaret nga gjendja financiare e viktimës.

Shpagimi

Me shpagim do të duhej të barazpeshohet dëmi jomaterial (vuajtjet shpirtërore) i cili është shkaktuar nga një vepër e dhunshme («paraja e dhimbjes»). Shpagimi kryhet pamvarësisht nga gjendja financiare e viktimës. Kërkesa me shkrim mund të parashtrohet në qoftë se si rezultat i krimit është shkaktuar një dëmtim i rëndë. Për shbull kjo mund të jetë

- në rast të delikteve seksuale, të cilat për pasojë kanë dëme psiqike;
- në rast të lëndimeve të rënda trupore me pasoja të rënda apo nëse shërimi zgjatë shumë gjatë;
- për trashëgimtarët mbas një delikti me vrasje;
- në rast të dhunës masive dhe të vazhdueshme, në qoftë se ato ndaj personit të prekur kanë për pasojë dëmtimet e rënda psiqike dhe kufizime në jetë.

Afatet

Kërkesat me shkrim për zhdëmtim dhe shpagim duhet të parastrohen mbrenda **afatit prej 5 viteve** pas momentit të krimit. Afati prej 5 viteve vlenë për krimet të cilat janë kryer që nga data 01.01.2007. Për krimet e mëparshme sipas rregullit e drejta tashmë është vjetërsuar (parashkuar). Për rregullimet e posaçme dhe përjashtimet vendosë autoriteti përgjegjës. Ne me dëshirë ju këshillojmë se si duhet të veprohet.

Kërkesat me shkrim sipas rregullit duhet të parashtrihen në adresen pasuese:

Departement Volkswirtschaft und Inneres
Opferhilfe
Zwinglistrasse 6
8750 Glarus

Vërtetim

Përmes kësaj vërtetoj se unë jam njoftuar nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave e Kantonit të Glarus-it për të drejtat e mija sipas Kodit të viktimës në lidhje me zhdëmtimin dhe shpagimin (kompensimin e viktimës).

Datum:

Unterschrift:
